



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së pestët të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10.06.2021,
duke filluar në orën 13:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Diellon Gjonbalaj përfaqësues i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Sami Boroci tha se sa i përket rendit të ditës shumica e pikave janë këmbime të pronave, i kam analizuar dhe kam hasur në shumë paqartësi në këto prona, ku edhe më herët vazhdimësi kam pas paqartësi, ne si asamblistë nuk po i kuptojmë mirë dhe nuk jemi të saktë me pa se çka po jep Komuna dhe çka po merr. Deri tani kam marrë shumë kërkesa prej njerëzve që nuk i njoh dhe më kanë telefonuar se në këtë rend dite nuk i kanë kërkesat e tyre për këmbim të pronave, të cilat kërkesa i kanë adresuar tash e një vit.

Unë propozoj seancë të ndahet në dy seanca, nëse ka nevojë edhe një Komitet me mbajtur sa më shpejt, për shkak se unë dua të kërkoj prej Drejtorisë së Pronës sqarime pse nuk janë ardhur disa pika të cilat unë i kam pasur si ankesa të qytetarëve, të cilët janë duke pritur tash një vit për këmbim, ose t'i trajtojmë krejt njësoj, sepse sipas qytetarëve, ka këtu prona që janë ardhur qe tre muaj për shqyrtim dhe janë këtu në rend dite, dhe kemi prona të cilat që një vit janë duke pritur dhe nuk janë për këtë seancë. Nëse mbesin në këtë formë, unë nuk besoj që do t'i votoj.

Agim Kuleta, kryesues, lidhur me propozimin për ndarje të mbledhjes, tha se është problem, pasi që më 15 qershor shpallet data e zgjedhjeve lokale në Kosovë, d.m.th. mbesin këto pa u kaluar. Pra, sipas kësaj del se pas shpalljes së zgjedhjeve nuk mund të ketë më këmbim të pronave.

Agim Gashi sa i përket datës 15, nëse ne propozojmë për me i ndarë pikat dhe pajtoshemi të gjithë, nesër mund të mbahet KPF-ja, me u trajtuar pjesa tjeter dhe të martën me vazhduar kuvendi i ri.

Ai shprehu mendimin se nëse shpallen zgjedhjet më 15 qershor, ajo hynë fuqi më 16.

Agim Kuleta, kryesues, ua bëri me dije të pranishmëve se me këtë që po propozohet, mund të rrezikohet.

Jeta Rafuna theksoi se nuk po rrezikojmë asgjë, sepse edhe ashtu për disa pika nuk kemi material.

Agim Gashi sa i përket lagjes "Lakërishta", theksoi se, me sa është e ditur, disa rrugë kanë me u ndërtuar dhe nuk është zgjidhur ai problem në detale, nuk e kemi materialin, por ne mund të takohemi para seancës, të hënën, nëse na vije materiali dhe ta trajtojmë këtë pikë, që të mos mbetet se drejtoria ka me pasur problem me i realizuar ato projekte.

Sami Boroci pyeti se a mundet deri të hënën drejtoria me na dërguar materialin në e-mail.

Egzon Azemi u shpreh se sa mund të jetë e logjikshme me i futur në rend dite propozimet për pronat të cilat kanë ardhur me u trajtuar qe 2 muaj, e me i lënë anash pronat që kanë aplikuar për këmbim ndoshta qe 2-3 vjet. Ky votim është parafushatë, selektimi është bërë në bazë të mbiemrave, pa currfarë arsyeshmërie.

Njëherësh ai informoi se dje e kanë dërguar një kërkesë për një seancë të jashtëzakonshme, por që mos të mbahet mbledhje e jashtëzakonshme, ai propozoi të futet si pikë e parë e rendit të ditës. Është kërkesa për rastin e Hortikulturës, ndërrimin e destinimit të laurës në hyrje të parkut "Gërmia", e cila i ka kaluar, me vendim të nënkytarit, kompanisë "Prishtina Parkingu", ku 17 asamblistë e kanë nënshkruar këtë kërkesë.

Vala Peshku parashtroi pyetje, duke thënë se a është fjala për ndërmarrjen "Hortikultura", për laurën në hyrje të parkut "Gërmia" që i ka kaluar ndërmarrjes "Prishtina Parkingu".

Agim Kuleta, kryesues, pyeti se cila është kërkesa për Kuvend.

Egzon Azemi tha se kërkesa është që laura në hyrje të parkut "Gërmia" të rikthehet në menaxhimin e ndërmarrjes "Hortikultura", nuk ka kuptim që një park rajonal si i tillë me u sistemuar si parking. Në rregull, parkingjet që kanë qenë jashtë laurës së Gërmisë, që gjithashtu kanë qenë në menaxhim të "Hortikulturës", me i kaluar tash e tutje pagesa Prishtinës, e pjesa tjeter e territorit të Gërmisë prej Pishinës e lart, është krejtësisht jo logjike nëse e trajtonë si parking, dhe aty kanë të drejtë veturat me u parkuar. Ideja është më e mirë që tani e tutje të jetë zonë ku inkuadrohen maksimalisht vetëm transportet publike, jo diçka tjeter, mos me pasur fare parking. Mirëpo nëse lejohet prapë si parking me numër të kufizuar, le të menaxhohet nga "Hortikultura" dhe ato fonde që iu kanë lejuar, tash e tutje me i marrë "Prishtina Parking", është më mirë ato fonde me i takuar ndërmarrjes "Hortikultura" dhe me ia rritur fushëveprimtarinë. Ne e dimë që 2/3 e territorit të Gërmisë nuk kanë roje pylli dhe ajo zonë dëmtohet vazhdimisht.

Vala Peshku tha ideja jote qenka me ndalur transportin, është jo logjike me kërkuare mos hyrjen e veturave në atë pjesë.

Egzon Azemi tha se nuk është ide e imja, por kërkesa ka ardhur prej punëtorëve të "Hortikulturës", me të cilën janë pajtuar 17 asamblistë të subjekteve të ndryshme. Kërkesa është që tani e tutje laura në hyrje të parkut "Gërmia" t'i rikthehet ndërmarrjes "Hortikultura".

Agim Gashi u shpreh se Kuvendi nuk është ai i cili e detyron ekzekutivin me ndërmarr hapa të tillë. Kuvendi mundet me votuar dhe me i sugjeruar, por jo me u përzier në çështje ekskluzive ekzekutivit menaxhuese për shkak se te dyja janë ndërmarrje komunale.

Egzon Azemi pyeti se pronë e kujt janë ndërmarrjet.

Agim Gashi tha pronë e Komunës.

Egzon Azemi tha se ligjërisht është pronë e Kuvendit komunal.

Agim Gashi tha është pronë e Komunës, prona e Komunës i përfshinë të gjitha segmentet institucionale, duke u nisur prej Kuvendit, kryetarit, ekzekutivit etj.

Egzon Azemi pyeti se kush e ka marrë Vendimin që ia ka marrë menaxhimin e laurës së Gërmisë "Hortikulturës", cili institucion.

Agim Gashi tha se nëse Kuvendi komunal duhet me marrë një vendim të tillë, ajo vjen prej ekzekutivit. Unë nuk jam për mos me ia dhënë në menaxhim laurën, por edhe nuk jam me ia dhënë, sepse ata punëtorë nuk humbin asgjë, vetëm kanë me ndërruar vendin ku kanë me punuar, se NPL "Hortikultura" e finançon 100% Komuna, as një aktivitet jashtë Komunës ajo nuk e bënë, s'ka të drejtë.

Agim Kuleta, kryesues, dha sqarime se kërkesa i ka ardhur atij dhe janë ardhur me biseduar, ua kam kërkuar të gjitha dokumentet që ata bazohen, në mënyrë që ta analizojë, më është sjellë materiali, aty gjendet një kontratë, kontratë valide e vitit 2003, dhe parashihet 10 vjeçare validiteti, që ka përfunduar në 2013 dhe parashihet që me vendim të Kuvendit kjo mundet me u prishur 30 ditë përpëra kohe vetëm me njoftuar 30 ditë përpëra, ata bazë ligjore nuk kanë prej 2013-ës.

Egzon Azemi theksoi se ligjërisht e ki çdo kontratë të cilës i kalon afati dhe skadon, dhe nëse nuk ka reagim prej asnjerës pale, llogaritet se është e vlefshme deri në marrjen e vendimit tjetër.

Agim Kuleta, kryesues, tha se vendimi është, pika e parë thotë: "Laura dhe parkingjet te parku "Gërmia", tani e tutje do të menaxhohen nga NPL "Prishtina Parking".

Pika 2 thotë: "Data e mbikëqyrjes së NPL "Prishtina Parking" është që nga data 17.05.2021".

Pika 3 thotë: "NPL "Hortikultura" nuk dëmtohet financiarisht aspak, kontrata aktuale e cila është valide vazhdon edhe viteve të tjera pa asnjë ndalesë financiare.

Pika e 4 thotë: "Punëtorët e NPL "Hortikultura" kthehen në NPL "Hortikultura" dhe kryeshefi mundet t'i transferojë në vende ku ka nevojë.

Ky vendim bazohet në rregulloren, të cilën e kemi votuar në Kuvend, e cila parashev që të gjitha parkingjet i kalojnë ndërmarrjes "Prishtina Parking", tash thotë: "Neni 4 i Rregullores që e kemi miratuar thotë "Vendparkingjet publike janë të gjitha vendparkingjet përgjatë rrugës publike dhe hapësirave të destiguara për parkingje publike, të cilat menaxhohen nga NPL "Prishtina Parking" e që janë përreth rrugëve".

Egzon Azemi tha se këto fonde deri sot NPL "Hortikultura" i ka mbledhur prej laurës, ia ka kthyer Komunës, Komuna ia ka mbuluar shpenzimet, me vendimin që e ka marrë nënkyetari, Muhedin Nushi, tash e tutje NPL "Prishtina Parking" nuk ja kthen më Komunës, por i mban vet dhe kërkesa është me bërë rikthimin e laurës në menaxhim të NPL "Hortikultura", Hortikultura mos me ia dhënë fondet Komunës siç ka vepruar deri sot, por me iu rritur buxhetin për me bërë më shumë investime të gjelbra.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime sa i përket financave. NPL "Hortikultura" financohet prej Komunës mesatarisht në vlerë 1 milion - 1 milion e 300 mijë është fondi i ndarë për krejt shërbimet që i kryen, Hortikultura dy vitet e fundit i ka mbledhur për gjithë vitin diku 20 mijë euro.

NPL "Prishtina Parking" më nuk ka me u subvencionuar me zgjerimin e këtyre, ka me sjellë raporte.

Jeta Rafuna bëri një propozoi lidhur me një vendim që e ka marrë Kuvendi për kompensimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike, ku shumica e dimë këtë problem që është në KUR "Pastrimi", ku kryeshefi i ndërmarrjes për shkak se ajo është ndërmarrje regionale, na ka thënë se nuk po gjen hapësirë ligjore me zbatuar, d.m.th. ka këruar me bërë një ndryshim në vendim, aty ku shkruan "Ndërmarrja Publike Lokale" me ia shtua edhe "KUR "Pastrimi""", çështja është me iu rregulluar që nesër aksionarët e tjerë që vinë mos të kemi probleme të tilla.

Agim Gashi tha se ka të drejt ai, sepse ka status më ndryshe.

Jeta Rafuna kërkoi me mirëkuptim që mos me pasur problem as sot as në të ardhmen.

Agim Kuleta, kryesues, tha se e rregulloj këtë çështje.

Kryesuesi pyeti se kush është për rendin e ditës.

Egzon Azemi kërkoi që së pari të votohet nga KPF-ja se a janë për me shti këtë pikë si pikë të parë apo jo, pastaj e votojmë rendin e ditës.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se ne mundemi si pika vetëm mi diskutuar këtu, për Kuvend kryetari dhe kryesuesi e bëjnë rendin e ditës.

Sami Boroci propozim si pikë, pasi që kishte marrë ankesa nga Bajrush Plakaj, Bedri Sadiku e Naser Havolli, të cilët kanë bërë kërkësë për më shumë se një vit për këmbim pronë dhe nuk janë në rend dite!

Ai kërkoi që t'i përcillet drejtorit, ekzekutivit, kjo vërejtje e dhënë.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01, 463/01- 27259/21, dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës ë paluajtshme të Komunës me pronë private;
3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë;

4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore, "Ujrat" Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi të PSH, BVI për Banim;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi -A" SHPK;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia", SHPK dhe Bedri Prishtina;
11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të New Company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka;
12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosova", SHPK;
13. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Humollit dhe "Agro Trade";
14. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit;
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit;
16. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Humollit;
17. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit;
18. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 110-21449, dt.28.02.2013;
19. Propozimvendimi për krijimin e komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban;
20. Të ndryshme.

Kryesuesi konstataoi se u miratua ky rend dite, më 7 vota për dhe 2 vota kundër.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se më 8 vota për dhe 1 kundër u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për plotësim ndryshimin e Vendimit, nr. 01, 463/01- 27259/21, dt. 11.02.2021 për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private.

Agim Gashi tha se në material tregohet se është bërë vlerësimi i pronës nga Ministria, nuk janë të barasvlefshme ato dy prona dhe se pronari i cili e ka ndërruar tokën me Komunën duhet me dhënë tokë më shumë e tanjë është caktuar parcela, kjo e kompenson atë dallim.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim ndryshimin e Vendimit nr. 01, 463/01- 27259/21, dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit.

Sami Boroci, sa i përket këtij këmbimi, unë e analizova, po jepet pronë në Zllatar e po merret pronë në Llukar, për mua nuk ka kurrfarë arsyeshmërie ky këmbim, kisha dëshiruar dikush me na shpjeguar më mirë nga ekzekutivi se ky këmbim duhet pasur barasvlerë.

Agim Gashi tha se Ministria e bën vlerësimin e pronave, të jemi në dijeni se nëpër Llukar ka me kaluar unaza e për ata duhet ato prona me i shpronësuar.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore "Ujërat" Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, pronë shoqërore, BVI për Banim.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore, "Ujërat" Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi, pronë shoqërore, BVI për Banim dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe Jahir (Liman) Sylejmanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmije (Murat) Rexhepit dhe Sami (Xhemajl) Qyqallës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi -A" SHPK.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi -A", SHPK, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia" SHPK dhe Bedri Prishtina.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Tregtia" SHPK dhe Bedri Prishtina, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të New Company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të New Company "Kosovashped", Pjetër Palushi dhe Shkelzen Noka, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dytëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosova" SHPK.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "Real Estate Kosova", SHPK dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Humollit dhe "Agro Trade".

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bedri Humollit dhe "Agro Trade", dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërmëbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman Jasharit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhep Shoshit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Humollit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Sutki Humollit dhe Betim Humollit dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Gashit dhe Fitim Gashit dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetëmbëdhjetë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, 01.nr.110-21449, dt.28.02.2013.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 110-21449, dt.28.02.2013 dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntëmbëdhjetë

Propozimvendimi për krijimin e komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban.

Agim Kuleta, kryesues, tha se këtu na ka kërkuar Fatosi me bërë komision, në rregull po e bëjmë, edhe pse me Ligj kishte mundur me u kryer edhe siç e cekëm në diskutim, me dakordim të subjekteve politike.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për krijimin e komisionit për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Agim Gashi propozoi që në rast se na sillet materiali për lagjen "Lakërishta", është mirë që

para seancës së Kuvendit me u takuar, të hënën, dhe ta trajtojmë këtë pikë si Komitet dhe ta kryejmë.

Egzon Azemi tha se është mirë me ia propozuar kryetarit kërkesën që me hy si pikë e rendit të ditës propozimi im dhe me ia sqaruar se 17 asamblistë e kanë përkrah këtë kërkesë, të jetë pikë e rendit, u votua apo nuk u votua.

Agim Gashi tha propozojani kryetarit dhe nëse e shtinë si pikë mirë.

Egzon Azemi u shpreh se po më intereson çka është duke ndodhur me pronat e NPL "Banesore", se punëtoret janë kushtëzua me dalë prej lokaleve atje dhe kemi marrë informacione se është duke u rrëzuar dhe është paraparë ndërtim. Po ashtu, e kemi pa një dokumente në faqen zyrtare të NPL "Banesore", ku nuk ka as numër protokolli, as nuk ka emër, as nënshkrim të ndonjë zyrtari që ka bërë thirrje për dy ditë për me aplikuar për bashkëfinancim, d.m.th. sipas meje ka shkelje ligjore.

Agim Kuleta, kryesues, e sugjeroi Egzonin se, aksionarët i kemi, ju shkruani aksionarëve, e-mailin e keni dhe iu kërkon informim me shkrim.

Valbona Ahmeti - Makolli, informoi se Ministria e Financave kur e ka bërë aprovimin e buxhetit për vitin 2021, shumica e Komunave i ka kaluar disa fonde në fondin rezervë, d.m.th. po kërkohet prapë votimi i tyre i projekteve që i kemi votuar në asamble komunale. Shtrohet pyetja se pse janë kaluare në fond rezervë. Kanë kaluare në fond rezervë për shkak se nuk kanë pasur dokumentacion të mjaftueshëm për Ministrinë e Financave.

Agim Kuleta, kryesues, tha përgatiteni dhe nuk ka problem.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Prosesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

